

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-216/2014

Prishtinë, 10 gusht 2016

Në çështjen juridike të:

T.S.

Reti e Poshtme
Rahovec

Pala ankuese

Kundër

G.N.

Rruga “Mukerova” nr. 101
Smederevska Palanka
Serbi

Pala përgjegjëse në ankesë/Paraqitësi i kërkesës

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) nr. KPCC/D/A/100/2011, të datës 23 shkurt 2011 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA29829), në tekstin e mëtejme gjithashtu: Vendimi i KKPK-së, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 10 gusht 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

Hedhet poshtë si e papranueshme ankesa e T.S. kundër vendimit të KKPK-së nr. KPCC/D/A/100/2011, të datës 23 shkurt 2011, për sa i takon kërkesës nr. KPA29829.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 7 maj 2007 G.D.N. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon vërtetimin e të drejtës pronësore mbi ngastrën e tokës në Bajdol-Jazbine, zona kadastrale Reti, Komuna e Rahovecit, ngastra numër 1043/1, e regjistruar në fletën poseduese nr. 25 e lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi me datë 9 qershor 2004, me sipërfaqe prej 12.55 ari (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Ajo ka pretenduar që babai i saj D.K. që kishte vdekur në vitin 1998 ceket si pronar i pronës së kërkuar. Ajo gjithashtu thekson se posedimi mbi pronën ishte humbur më 12 qershor 1999 për shkak të rrethanave gjatë viteve 1998/1999.
2. Pala përgjegjëse në ankesë ka dorëzuar *inter alia* në AKP fletën poseduese nr. 25 të lëshuar nga Komuna e Rahovecit, zona kadastrale Reti, të datës 9 qershor 2004; sipas kësaj flete poseduese D.K. është i regjistruar si pronar i ngastrës nr. 1043/1 (kullosë e klasës së 3-të) në Bajdol-Jazbine.
3. AKP-ja kishte bërë njoftimin e kërkesës më 2 mars 2010 duke vendosur një afishe me informacion për kërkesën ndaj pronës së kërkuar. Ekipi njoftues gjeti se prona e kërkuar ishte një tokë e kultivuar dhe e uzurpuar nga një person i panjohur. Identifikimi i personit që e shfrytëzonte pronën e kërkuar ishte i pasuksesshëm pasi që disa nga banorët lokal nuk kishin informata dhe disa të tjerë nuk ishin bashkëpunues për të treguar. Më 4 mars 2010 AKP-ja vërtetoi se njoftimi ishte i saktë bazuar në ortofoton dhe koordinatat e GPS-it.

4. Asnjë palë tjetër nuk kishte marrë pjesë në procedurën para KKPK-së.
5. AKP-ja kishte bërë verifikimin pozitiv të fletës poseduese të dorëzuar nga pala përgjegjëse në ankesë.
6. KKPK kishte vendosur në Vendimin e KKPK-së *“që Paraqitësi i kërkesës...ka...dëshmuar se D.D.K. është pronar me 1/1 e pronës së kërkuar; dhe urdhëron që:*

D.D.K. ka të drejtë në posedimin e pronës ...”

KKPK-ja e pranon palën përgjegjëse në ankesë si anëtar të familjes së ngushtë të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore. KKPK-ja për më tepër ka urdhëruar çdo person tjetër që ka uzurpuar pronën e kërkuar ta liroj atë ose përndryshe do të dëbohet nga ajo.
7. Vendimi i ishte dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 8 gusht 2011. Në ditën e njëjtë ajo ka kërkuar administrimin e pronës së kërkuar. Më 27 shtator 2012 AKP-ja kishte vendosur të vendoste pronën e kërkuar nën administrimin e AKP-së.
8. Më 25 gusht 2014 pala ankuese kishte pranuar nga AKP-ja vendimin e KKPK-së.
9. Pala ankuese kishte paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së më 5 shtator 2014.
10. Pala përgjegjëse në ankesë kishte dërguar përgjigje ndaj ankesës me datën 8 dhjetor 2014.

Pretendimet e palëve

11. Pala ankuese e pohon se D.K. ishte bartësi i së drejtës pronësore në pronën e kërkuar por thekson se ai e kishte blerë pronën e kërkuar nga D.K. në vitin 1985 dhe pastaj ishte kthyer në Zvicër. Gjithashtu ai thekson se ai e kishte shfrytëzuar tokën që nga viti 1985. Ai thekson se ekzistonte një kontratë e shkruar lidhur me këtë shitblerje. Palët nuk e kishin regjistruar shitjen dhe bartjen në librat kadastral. Pala ankuese gjithashtu

thekson se ai nuk kishte qenë në dijeni për procedurën para AKP/KKPK-së para se ta pranonte vendimin e KKPK-së dhe prandaj nuk ishte në gjendje të përgjigjej në kërkesë dhe të dorëzoj prova në një fazë të mëhershme. Për të mbështetur pretendimet e tij ai dorëzon deklaratat e dy personave, vëllait të tij S.Q. dhe kushëririt të largët Q.V.

12. Pala përgjegjëse në ankesë e kundërshton të drejtën e palës ankuese për ankesë pasi që ai nuk kishte qenë palë në shkallën e parë para AKP/KKPK-së. Së dyti, ajo thekson se është trashëgimtare e babait të saj, pronarit të pronës së kërkuar. Ai nuk e ka shitur pronën. Nuk kishte pasur ndryshim të pronësisë. Babai i saj ishte kidnapuar dhe vrarë në vitin 1998.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

13. Ankesa është e papranueshme nëse pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurën para KKPK-së, përveç nëse pala ankuese është palë e interesit i cili nuk ka marrë njoftimin e kërkesës ose përndryshe nuk ka qenë në dijeni dhe me arsye nuk ka mundur të jetë në dijeni për kërkesën para se të bënte ankesën (neni 12.1 i lidhur me nenet 10.1 – 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079; në tekstin e mëtejme: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50; shih p.sh. Aktgjykimet e Gjykatës Supreme të datës 12 mars 2014, GSK-KPA-A-152/2013 dhe 13 maj 2015, GSK-KPA-A-086/2014).
14. Nuk ka ndonjë indikacion se AKP-ja ishte në dijeni apo se duhet të jetë në dijeni që pala ankuese ishte palë e interesuar në këtë lëndë. Prandaj, AKP-ja nuk ishte në gjendje dhe rrjedhimisht nuk kishte obligimin t'ia dërgonte kërkesën palës ankuese. Njoftimi i kërkesës ishte bërë duke e vendosur një afishe në pronën e kërkuar. Në rrethanat e rastit kjo mënyrë e bërjes së njoftimit mbi kërkesën, siç është vendosur tashmë nga Gjykata Supreme në rastet e mëhershme, është e mjaftueshme dhe në përputhje me nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

15. Në këtë pikë Gjykata Supreme konstaton, se, nëse në të vërtetë do të ishte pala ankuese ai i cili e shfrytëzonte pronën e kërkuar që nga viti 1985 siç thekson ai vet, ai duhet ta ketë vërejtur afishen me informacionin për kërkesën lidhur me ngastrën që ceket më lartë në paragrafin 3.
16. Prandaj, duhet të konstatohet se pala ankuese ishte në dijeni apo me arsye ka mundur të jetë në dijeni për kërkesën dhe procedurën para AKP/KKPK-së, por nuk ka marrë pjesë në procedurën në shkallë të parë. Pasi që nuk ishte palë në shkallë të parë ai nuk mund të bëhet palë në ankesë (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe neni 176.1 i Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore).

Konkludim

17. Rrjedhimisht, në përputhje me nenin 13.3, nën-paragrafi b të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Gjykata Supreme vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për të hedhur poshtë ankesën për arsye procedurale.

Këshillë juridike

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it